	Environment“, 9th International Conference on Social Computing and Social Media, Held as Part of HCI International 2017, Vancouver, Canada, July 9- 14, 2017, <b>Springer, 2017</b> . E indeksuar në <b>Web of Science</b> , (3 autorë – 80% të pikëve maksimale 3)	
1.4	Daut Hajrullahi, <b>Florim Idrizi</b> and Burhan Rahmani, The Implementation of the Document Management System “DocMan” as an advantage for the acceleration of administrative work in Macedonia, 14th International Conference on Information Technology- New Generations (ITNG), April 10-12, 2017, <b>Springer, 2017</b> , E indeksuar në <b>Web of Science</b> , (3 autorë – 80% të pikëve maksimale 3)	<b>3x0.8=2.4</b>
1.5	Luma-Osmani, Shkurte; <b>Idrizi, Florim</b> ; “ <i>The impact of using technology in the teaching process - A case study</i> ” 1 <sup>st</sup> International Conference of Natural Sciences and Mathematics of UT –ICNSM 2017, 16-17 <b>June 2017</b> , Tetova, Republic of Macedonia	<b>1</b>
1.6	Simbile Iseini, <b>Florim Idrizi</b> Mirsade Neziri, The role and importance of managing Information security in the organization , Challenges of doing business in dhe contemporary world” 5 <sup>th</sup> INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERNEC , <b>2017</b> , Tetova, Republic of Macedonia	<b>1</b>
1.7	Shkurte Luma-Osmani, Bekim Fetaji, <b>Florim Idrizi</b> , Social Login Approach Introduced as a Higher Education Demand-Based Model. INTERNATIONAL CONGRESS on NATURAL and ENGINEERING SCIENCES, <a href="http://www.icnes.gen.tr">http://www.icnes.gen.tr</a> , <b>2016</b> .	<b>1</b>
1.8	Agon Memeti, Florinda Imeri, <b>Florim Idrizi</b> , Challenges for Building the University LMS while using Open-Source Frameworks, INTERNATIONAL CONGRESS on NATURAL and ENGINEERING SCIENCES, <a href="http://www.icnes.gen.tr/">http://www.icnes.gen.tr/</a> , <b>2016</b> .	<b>1</b>
1.9	Burhan Rahmani, <b>Florim Idrizi</b> , Agon Memedi Implementation of Health Cards in all e-government Systems in Macedonia, INTERNATIONAL CONGRESS on NATURAL and ENGINEERING SCIENCES, <a href="http://www.icnes.gen.tr/">http://www.icnes.gen.tr/</a> , <b>2016</b> .	<b>1</b>
1.10	Shpëtim Rexhepi, <b>Florim Idrizi</b> , Egzona Iseni, Arlind Jakupi, On Convergence of Series That Has to do with Zeros of Function Belonging to Nevanlinna Class and Some Results of Blaschke Product, INTERNATIONAL CONGRESS on NATURAL and ENGINEERING SCIENCES, <a href="http://www.icnes.gen.tr/">http://www.icnes.gen.tr/</a> , <b>2016</b> .	<b>1</b>
1.11	Nexhibe Sejfuli - Ramadani, Verda Misimi, Erenis Ramadani, <b>Florim Idrizi</b> , The Role and the Impact of Digital Certificate and Digital Signature in Improving Security During Data Transmission, ICSD International Conference on sustainable Development, 19-23October <b>2016</b> , Skopje, Macedonia.	<b>1</b>
1.12	Shkurte Luma-Osmani, <b>Florim Idrizi</b> , Artrim Qamili, Comparison	

	studies of e-learning LMS'es in higher education institutions in the Republic of Macedonia, ICSD International Conference on sustainable Development, 19-23 October <b>2016</b> , Skopje, Macedonia	1
1.13	Safije Sadiku, <b>Florim Idrizi</b> , Shkurte Luma-Osmeni, Gjulie Arifi , Safety aspects and the role of data in electronic marketing, ICSD International Conference on sustainable Development, 19-23 October <b>2016</b> , Skopje, Macedonia	1
1.14	Fisnik Dalipi, Ali Shariq Imran, <b>Florim Idrizi</b> , Hesat Aliu, "An Analysis of Learner Experience on MOOCs in Mobile and PC Learning Environment", Advances in Intelligent Systems and Computing, <b>Springer, 2016</b> . E indeksuar në <b>Web of Science</b> , (3 autorë – 80% të pikëve maksimale 3)	<b>3x0.8=2.4</b>
1.15	Raman Ismaili, <b>Florim Idrizi</b> , Information Technologies in Function of Direct Marketing, The Impact of US Policy in Promoting Democracy, Peace, State – Building, Economic Recovery, and the Protection of National, Religious and Civic Values in the Countries of the Region, December 15, <b>2016 Tetova</b>	2
1.16	Fisnik Dalipi, <b>Florim Idrizi</b> , Eip Rufati, Florin Asani, On Integration of Ontologies into E-learning Systems, Sixth International Conference on Computational Intelligence, Communication Systems and Networks - IEEE ,Tetovë, Maqedoni. Proceedings of the Conference, <b>IEEE.ISBN 978-1-4799-5076-8,27 Maj 2014</b> . E indeksuar në <b>Web of Science</b> , (4 autorë – 60% të pikëve maksimale 3)	<b>3x0.6=1.8</b>
1.17	Shkurte Luma, Gjulie Arifi, <b>Florim Idrizi</b> , Choosing the Most Suitable Model for Developing a Software, Sixth International Conference on Computational Intelligence, Communication Systems and Networks - IEEE ,Tetovë, Maqedoni. Proceedings of the Conference, <b>IEEE. ISBN 978-1-4799-5076-8,27 Maj 2014</b> . E indeksuar në <b>Web of Science</b> , (3 autorë – 80% të pikëve maksimale 3)	<b>3x0.8=2.4</b>
<b>2.</b>	<b>Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë të njohur shkencore/profesionale</b>	
<b>2.1</b>	Vjollca Ismaili, Fisnik Dalipi, <b>Florim Idrizi</b> , Qebir Shemshiu, A Study on Learner's Perceptions of Moodle and Blackboard for Blended, Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, Vol. 2, No.3, <b>2017</b> (4 autorë – 80% të pikëve maksimale 4)	<b>4x0.8=3.2</b>
<b>2.2</b>	Shpresime Ibraimoski, <b>Florim Idrizi</b> , Systems for Online Payment: E-banking, E-commerce and Digital Currency, International Journal of Mechatronics, Electrical and Computer Technology (IJMEC), Vol. 7(24), Apr. <b>2017</b> , PP. 3335-3343 (2 autorë – 90% të pikëve maksimale 4)	<b>4x0.9=3.6</b>
<b>2.3</b>	<b>Florim Idrizi</b> , Agon Memeti, Burhan Rahmani, Analysis and comparison	<b>4x0.8=3.2</b>

	of DES cryptographic algorithm and AES cryptographic algorithm in different CPU, International Journal of Science, Inovation and new Technology, Vol. 6, No. 16, July, <b>2016</b> (Issue no. 16 July 2016) (3 autorë – 80% të pikëve maksimale 4)	
<b>2.4</b>	Shpresime Ibraimoski, <b>Florim Idrizi</b> , A Survey of Online Payment Applications in South Eastern Europe and in North America, in International Journal on Information Technologies & Security Year. 6, No. 2, <b>2016</b> , P.P 23-30. E indeksuar në <b>Web of Science</b> , (2 autorë – 90% të pikëve maksimale 4)	<b>4x0.9=3.6</b>
<b>2.5</b>	<b>Florim Idrizi</b> , Burhan Rahmani, Agon Memedi, Analysis and comparison of Gauss and Gauss-Jordan methods and their algorithms, for the selection linear equation system. In International Journal of Science, Inovation and new Technology. Vol. 1, No. 15, March, <b>2016</b> , P.P 35-38. (Issue no. 15 March 2016) , (3 autorë – 80% të pikëve maksimale 4)	<b>4x0.8=3.2</b>
<b>2.6</b>	Burhan Rahmani, <b>Florim Idrizi</b> , Festim Halili, An Analysis of Development of E-government in Macedonia and Creating a Mobile Application for the Secretariat for European Affairs, in International Journal on Information Technologies & Security Year. 6, No. 2, <b>2016</b> , P.P 15-22. E indeksuar në <b>Web of Science</b> , (3 autorë – 80% të pikëve maksimale 4)	<b>4x0.8=3.2</b>
<b>2.7</b>	Nexhibe Sejfuli, <b>Florim Idrizi</b> , Erenis Ramadani, Analysis and Comparison of the Sensors Used in Mobile Devices, in International Journal on Information Technologies & Security Year. № 1 (vol. 8), <b>2016</b> , E indeksuar në <b>Web of Science</b> , (3 autorë – 80% të pikëve maksimale 4)	<b>4x0.8=3.2</b>
<b>2.8</b>	Burhan Rahmani, Florim Idrizi, An Analysis of Macedonia's Position in the World Ranking in Years for E-government and the Development of an (Online) Application for the Submission of Corruption, International Journal of Computer Science and Technology vol 6, Issue 2, April – June <b>2015</b> , (2 autorë – 90% të pikëve maksimale 4)	<b>4x0.9=3.6</b>
<b>2.9</b>	Blerim Beqiri, <b>Florim Idrizi</b> , A survey an effective use of information technology in high schools, European Journal of Research and Reflection in Educational Sciences, Vol. 3 No. 4, <b>2015</b> , ISSN 2056-5852,(2 autorë – 90% të pikëve maksimale 4)	<b>4x0.9=3.6</b>
<b>2.10</b>	<b>Florim Idrizi</b> , Avni Rustemi, Analysis of some several elements of cryptography and proposing a new model for data security, Bulgarian Journal for Engineering Design, issue 30, October 2016	<b>4x0.9=3.6</b>
	<b>Gjithsej</b>	<b>60.6</b>

### III. VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJËRË

Nr.	Emri i aktivitetit:	Pikët
<b>1.</b>	2014-2017 Anëtarë i komisionit për evaluim në Universitet	<b>4</b>
<b>2.</b>	2012 – në vazhdim Prodekan i FSHMN-së	<b>8</b>

3.	2010 - në vazhdim Shef i Programit Studimorë	6
4.	Anëtar i komisionit recensues, të projekteve ndërshtetërore Maqedoni-Slloveni më vitin 2016. Emëruar nga MASH-i në Republikën e Maqedonisë.	1
5.	Anëtar në bordin editorial dhe organizativ të konference INTERNATIONAL CONGRESS on NATURAL and ENGINEERING SCIENCES, <a href="http://www.icnes.gen.tr/">http://www.icnes.gen.tr/</a> , 2016	2
6.	Anëtar i bordit të revistës: “ <i>Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT</i> ”	1
7.	Punëtorja “Google Your Future - Hackathon Event”; organizuar nga Google Inc. dhe Universiteti i Tetovës, Shkurt 2016; Tetovë	1
8.	Anëtar në bordin organizativ të konferences Sixth International Conference on Computational Intelligence, Communication Systems and Networks - IEEE ,Tetovë, Maqedoni. Proceedings of the Conference, IEEE.ISBN 978-1-4799-5076-8,27 Maj 2014	1
9.	Anëtar në bordin editorial dhe organizativ të konferences International Conference of Natural Sciences and Mathematics, 2017, 2018	2
10.	Anëtar i komisionit për pranimin e studentëve në ciklin e parë 2013 -2017	4
11.	Anëtar i komisionit për transferim 2013 – 2017	4
12.	Anëtar i komisionit në vlerësimin e kandidatëve në konferencën e parë dhe dytë të doktoraturës në Fakultetin ekonomik.	2
13.	Përgatitje e elaboratit për akreditimin e ciklit të parë të drejtimit Telekomunikime dhe teknologji kompjuterike, Informatika e Biznesit.	2
14.	Përgatitje e elaboratit për akreditimin e ciklit të dytë të drejtimit E-Teknologjitë, Sistemet e bazave të të dhënave	2
15.	Anëtarë i komisioneve në FSHMN dhe në programin studimor informatikë	10
16.	Kontrollues i pyetjeve të provimit ekstern për shkolla e mesme 2016, 2017	2
17.	Anëtarë i komisionit recensues në zgjedhjen në thirrjen mësimore - shkencore (4x0.5=2)	2
18.	Mendim në vlerësimin e punimeve të doktoraturës të disa kandidateve.	3
19.	Përkthyes i librit dhe lektor i librit – projektit “Përkthim i 1000 teksteve profesionale” TELECOMMUNICATIONS ESSENTIALS, SECOND EDITION: THE COMPLETE GLOBAL SOURCE, 2nd Edition; 9780321427618 by GOLENIEWSKI, LILLIAN; JARRETT, KITTY WILSON, published by Pearson Education, Inc, publishing as Addison-Wesley Professional. Copyright © 2007	8
20.	I angazhuar, trajnuar për licencimin e drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme. 2015-2018	3
	<b>Gjithsej</b>	<b>68</b>

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE</b>	<b>Pikët</b>
<b><i>VEPRIMTARIA MËSIMORE - ARSIMORE</i></b>	<b>244.706</b>
<b><i>VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE</i></b>	<b>60.6</b>
<b><i>VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJËRË</i></b>	<b>68</b>
<b>GJITHSEJ</b>	<b>373.306</b>

**Komision recensues:**

1. **Prof. Dr. Agni Dika, Profesor *Ordinar*** - kryetar
2. **Prof. Dr. Aleksandar Risteski, Profesor *Ordinar*** - anëtar
3. **Prof. Dr. Ilija Ninka, Profesor *Ordinar*** - anëtar

Tetovë, 26.06.2018



## **R E F E R A T**

### **PËR ZGJEDHJEN E NJË BASHKËPUNËTORI NË THIRRJEN ASISTENT NË FUSHËN E FIZIKËS NË FAKULTETIN E SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE NË UNIVERSITETIN E TETOVËS**

Me Vendim të Këshillit të Rektoratit të datës 20. 06. 2018, arkivuar më datë 22. 06. 2018 me numër Nr. 02-2672/1, është formuar komision Recensues për zgjedhjen e një asistenti nga fusha e fizikës për lëndët *Elektroteknikë* dhe *Spektroskopi*, sipas konkursit të publikuar më 04. 06. 2018 në gazetën e përditshme “Koha” dhe “Nova Makedonia”, si dhe në ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, në përbërje:

1. Doc. Dr. Fadil Ajredini, kryetar
2. Prof. Dr. Naim Mahmudi, anëtar
3. Doc. Dr. Neset Izairi, anëtar

Komisioni në përbërje të plotë, si më sipër, pasi e kontrollloi materialin e konkursit, titullit të lartë përmendur i paraqet këtë

## **R E C E N S I O N**

Nga konkursi i publikuar më 04.06.2018 në ueb faqen e universitetit ([www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk)) mund të vërehet se në të është shpallur për zgjedhje vendi i punës për një asistent nga fusha e fizikës në Fakultetin e shkencave matematikore-natyrore për lëndët *Elektroteknikë* dhe *Spektroskopi*.

Komisioni pas kontrollimit të materialit të konkursit, nga dokumentacioni, konstatoi se në konkurs është paraqitur vetëm një kandidat, edhe atë Mr. Mirjeta Mediji Arifi, asistent Part-Time në Fakultetin e shkencave matematikore-natyrore të Universitetit të Tetovës.

### **1. Mr.Sc. Mirjeta Mediji Arifi**

#### **I. TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL**

Mirjeta Mediji Arifi ka lindur më 16 shkurt 1982 në fshatin Përshefcë, Komuna e Tercës, Tetovë, ku edhe ka mbaruar shkollën fillore. Shkollën e mesme, Gjimnazin “Kiril Pejçinoviç” e ka kryer në vitin 2001/2002 në Tetovë.

Në vitin 2001/02 është regjistruar në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Prishtinë në fizikë, drejtimi fizikë inxhinierike, ku edhe ka fituar titullin *Bachelor i fizikes Inzhinjerike*. Vlen të theksohet se kandidati ka qene edhe bursiste e Universiteti te Prishtinës si student e dalluar.

Në vitin akademik 2010/2011 ka regjistruar studimet pasdiplomike në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Prishtinë në drejtimin *Fizikën e përgjithshme*. Pasi i ka dhënë me sukses të dalluar të gjitha provimet e parapara sipas programit, më 12. 10. 2015 ka mbrojtur temën e masterit me titull *”Formulimi bashkëkohor i modelit standard”* ku është vlerësuar me notë maksimale dhe ka fituar titullin *”Magjistër i Shkencave të Fizikës”*.

Në vitin akademik 2017/2018 ka regjistruar studimet e doktoraturës (cikli i tretë) në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Universitetin “Shën Kiril dhe Matodij” në Shkup dhe aktualisht ka mbaruar me ligjëratat e semestrit të dytë si dhe i ka dhënë dy provime që janë paraparë sipas programit të studimeve të doktoraturës.

Gjatë periudhës së arsimit të mesëm dhe të lartë ka marrë pjesë në gara të ndryshme të fizikës dhe matematikës, ku edhe ka fituar disa diploma dhe mirënjohje.

## **II. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE**

Mr. Sc. Mirjeta Mediji Arifi, ka ushtruar profesionin e arsimtarit në shkolla të mesme si dhe të asistentit ( Part Time) në disa shkolla të mesme si në vijim.

- Prej vitit 2008/2009 deri më 2011/2012 ka punuar si profesor i fizikës në Shkollën e Mesme profesionale “Mosha Pijade” në Tetovë, në ndërkohë ka ligjëruar lëndën e fizikës në shkollën mesme të integruar dygjuhësore “Nansen Dialogue Centre Skopje” në Prelubisht, komuna e Jogunovcës. Poashtu, gjatë vitit shkollor 2008/2009 ka mbajtur mësim edhe në shkollën e mesme të mjekësisë “Nikola Shtein” në Tetovë.
- Nga viti shkollor 2012/2013 deri më 2014/2015, ka punuar si profesor i fizikës në Gjimnazin e Tetovës “Kiril Pejcinoviq” në Tetovë.
- Me ndarjen e gjimnazit të Tetovës në dy gjimnaze në vitin shkollor 2014/2015 është transferuar në Gjimnazin “7 Marsi” në Tetovë ku edhe aktualisht është e punësuar.
- Në ndërkohë, për shkak të nevojave të katedrës së fizikës për kuadër të ri, në vitin akademik 2010/2011 si dhe në vitet akademike 2016/2017 e në vijim, ka qenë dhe aktualisht është e angazhuar si asistente Part Time në FSHMN të Universitetit e Tetovës për mbajtjen e ushtrimeve numerike dhe laboratorike në programe të ndryshme studimore.

Gjatë angazhimit që ka pasur si asistente ajo ka mbajtur ushtrime numerike dhe laboratorike në programe të ndryshme studimore në lëndët si në vijim:

- Biofizika (ushtrime laboratorike dhe ushtrime numerike) në programin studimor Farmaci – FSHM.
- Fizika (ushtrime laboratorike dhe ushtrime numerike) në programin studimor Teknologji ushqimore dhe Të ushqyerit në FTU.
- Fizika e mjedisit jetësor në programin studimor Fizikë - FSHMN.
- Statistika dhe bazat e matjeve në programin studimor Fizikë - FSHMN.
- Spektroskopi në programin studimor Fizikë dhe Fizikë-Kimi në FSHMN.
- Elektroteknika në programin studimor Fizikë - FSHMN.
- Fizikë në programin studimor Biologji – FSHMN.
- Biofizikë (ushtrime laboratorike) në programin studimor Fizioterapi të FSHM.

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën e zgjedhjes në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe asistent (bashkëpunëtorit) në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), kandidatja Mr. Mirjeta Mediji Arifi ka realizuar gjithsej **20.558 pikë** nga veprimtaria mësimore-arsimore.

### **III. VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE**

#### **A. Libra të botuar**

1. Burhanedin Neziri, **Mirjeta Mediji**, Fizika për vitin e parë të shkollave të mesme profesionale (Dispensë), Tetovë 2009;
2. Burhanedin Neziri, **Mirjeta Arifi**, Fletore pune për fizikë për shkolla të mesme profesionale për vitin e parë, Tetovë 2009;
3. Burhanedin Neziri, **Mirjeta Arifi**, Fletore pune për fizikë për shkolla të mesme profesionale për vitin e dytë, Tetovë 2010;
4. Burhanedin Neziri, **Mirjeta Arifi**, Fletore pune për fizikë për shkolla të mesme profesionale për vitin e tretë, Tetovë 2010

#### **B. Redaktime profesionale**

1. Burhanedin Neziri, Fizika për vitin e dytë të shkollave të mesme të mjekësisë, Tetovë 2008

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të asistentit (bashkëpunëtorit) të Universitetit të Tetovës (Buletini i universitetit), kandidatja Mr. Mirjeta Mediji Arifi ka realizuar gjithsej **27 pikë**.

#### **IV. VEPRIMTARIA NGA INTERESI MË I GJERË**

Kandidati ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme profesionale si:

1. Interethnic Integration in Education Project – Projekt i USAID, Tetove, 2016
2. Zbatimi i përmbytjeve për risi dhe sipërmarrje ne programin mësimor për arsim në Republikën e Maqedonisë – Projekt i C.E.S, Tetove, 2012
3. Aplikimi i metodave dhe teknikave interaktive , Byroja për zhvillimin e arsimit,Tetovë 2016

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të asistentit (bashkëpunëtorit) në Universitetin të Tetovës (Buletini i Universitetit), kandidatja Mr. Mirjeta Mediji Arifi ka realizuar gjithsej **3 pikë** nga veprimtaritë me interes më të gjerë.

#### **VI. FORMULARI PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE**

Në shtojcë është bashkangjitur formulari për raportin e zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore. Kandidatja Mr. Mirjeta Mediji Arifi ka grumbulluar gjithsej **50.558 pikë**, edhe atë për: veprimtarinë mësimore-arsimore **20.558 pikë**, veprimtarinë profesionale-aplikative **27 pikë** dhe veprimtaritë me interes më të gjerë **3 pikë**.

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE</b>	<b>Pikët</b>
VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE	<b>20.558</b>
VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE	<b>27</b>
VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË	<b>3</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>50.558</b>

## PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Në bazë të pasqyrës të prezantuar më lartë, Komisioni recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-aplikative dhe veprimtarinë me interes më të gjerë, konstaton se kandidatja **Mr. Sc. Mirjeta Mediji Arifi** në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të asistentit (bashkëpunëtorit) në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), i plotëson kriteret për zgjedhje në thirrjen që ka konkurruar.

Komisioni Recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit të rektoratit të Universitetit të Tetovës që kandidatja **Mr. Sc. Mirjeta Mediji Arifi** të zgjidhet në thirrjen **asistent** për lëndët **Elektroteknikë** dhe **Spektroskopi**.

Tetovë, Qershor 2018

### ANËTARËT E KOMISIONIT RECENSUES:

1. **Doc. Dr. Fadil Ajredini, kryetar**

---

2. **Prof. Dr. Naim Mahmudi, anëtar**

---

3. **Doc. Dr. Neset Izairi, anëtar**

---

## S H T O J C Ë

### PËR RECENSIONIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

**Kandidati:** Mirjeta Reshat Mediji Arifi  
(emri, emri i prindit dhe mbiemri)

**Institucioni:** Fakulteti i shkencave matematike-natyrore – USHT, Tetovë  
(emri i fakulteti/institucionit)

**Lëmia shkencore:** Fizikë

#### I. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
	<b>I.2 Mbajtja e ushtrimeve</b> (lëndët në ciklin e parë të studimeve)	<b>19.80</b>
<b>I.1</b>	Biofizikë në Farmaci (3+3), 1 semestër	$1 \times 15 \times 3 \times 0.03 = 1.35$
	Fizika në Teknologji ushqimore - FTU (3+2), 3 semestra	$3 \times 15 \times 3 \times 0.03 = 4.05$
	Fizika në Të ushqyerit - FTU (2+2), 3 semestra	$3 \times 15 \times 3 \times 0.03 = 4.05$
	Fizika e mjedisit jetësor (2+2), 1 semestër	$1 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 0.90$
	Statistika dhe bazat e matjeve fizike (2+1), 2 semestër	$1 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 0.90$
	Spektroskopi në fizikë (2+4), 2 semestra	$2 \times 15 \times 4 \times 0.03 = 3.60$
	Spektroskopi në fizikë-kimi (2+2), 1 semestra	$1 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 0.90$
	Elektroteknikë (2+2), 2 semestra	$2 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 1.80$
	Fizika në Biologji (2+2), 2 semestra	$2 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 1.80$
	Biofizikë në Fizioterapi (2+1), 1 semestra	$1 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.45$
		<b>Konsultime me studentë</b>
<b>I.2</b>	Biofizikë në Farmaci (3+3), 1 semestër	$80 \times 1 \times 0.002 = 0.160$
	Fizika në Teknologji ushqimore - FTU (3+2), 3 semestra	$30 \times 3 \times 0.002 = 0.180$
	Fizika në Të ushqyerit - FTU (2+2), 3 semestra	$12 \times 3 \times 0.002 = 0.072$
	Fizika e mjedisit jetësor (2+2), 1 semestër	$7 \times 1 \times 0.002 = 0.014$
	Statistika dhe bazat e matjeve fizike (2+1), 2 semestër	$7 \times 2 \times 0.002 = 0.028$
	Spektroskopi në fizikë (2+4), 2 semestra	$10 \times 2 \times 0.002 = 0.040$
	Spektroskopi në fizikë-kimi (2+2), 1 semestra	$12 \times 2 \times 0.002 = 0.048$
	Elektroteknikë (2+2), 2 semestra	$7 \times 2 \times 0.002 = 0.028$
	Fizika në Biologji (2+2), 2 semestra	$12 \times 2 \times 0.002 = 0.048$
	Biofizikë në Fizioterapi (2+1), 1 semestra	$70 \times 1 \times 0.002 = 0.140$
<b>I</b>	<b>Gjithsej(I.1 – I.2):</b>	<b>20.558 pikë</b>

#### II. VEPRIMTARI PROFESIONALE-APLIKATIVE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
	<b>Libra të botuar për shkolla fillore ose të mesme</b>	<b>24</b>
<b>II.1</b>	Burhanedin Neziri, Mirjeta Mediji, Fizika për vitin e parë të shkollave të mesme profesionale (Dispensë), Tetovë 2009	6
	Burhanedin Neziri, Mirjeta Arifi, Fletore pune për fizikë për sholla të mesme profesionale për vitin e parë, Tetovë 2009	6

	<b>Burhanedin Neziri, Mirjeta Arifi, Fletore pune për fizikë për sholla të mesme profesionale për vitin e dytë, Tetovë 2010</b>	<b>6</b>
	Burhanedin Neziri, <b>Mirjeta Arifi</b> , Fletore pune për fizikë për sholla të mesme profesionale për vitin e tretë, Tetovë 2010	6
<b>II.2</b>	<b>Redaktim profesional – Recensentë</b>	<b>3</b>
	Burhanedin Neziri, Fizika për vitin e dytë të shkollave të mesme të mjekësisë, Tetovë 2008	<b>3</b>
<b>II</b>	<b>Gjithsej (II.1-II.2):</b>	<b>27</b>

### III. VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË

<b>Nr. rendor</b>	<b>Emri i aktivitetit:</b>	<b>Pikët</b>
<b>IV.1</b>	<b>Pjesëmarrëse në trajnime të ndryshme profesionale</b>	<b>3</b>
	Interethnic Integration in Education Project – Projekt i USAID, Tetove, 2016	<b>1</b>
	Zbatimi i përmbajtjeve për risi dhe sipërmarrje ne programin mësimor për arsim në Republikën e Maqedonisë – Projekt i C.E.S, Tetove, 2012	<b>1</b>
	Aplikimi i metodave dhe teknikave intereaktive , Byroja për zhvillimin e arsimit, Tetovë 2016	<b>1</b>

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE</b>	<b>Pikët</b>
<b>VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE</b>	20.558
<b>VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE</b>	27.000
<b>VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË</b>	3
<b>Gjithsej</b>	<b>50.558</b>

Tetovë, Qershor 2018

**ANËTARËT E KOMISIONIT RECENSUES:**

**1. Doc. Dr. Fadil Ajredini, kryetar**

\_\_\_\_\_

**2. Prof. Dr. Naim Mahmudi, anëtar**

\_\_\_\_\_

**3. Doc. Dr. Neset Izairi, anëtar**

\_\_\_\_\_

## REFERAT

### PËR ZGJEDHJEN E NJË ASISTENTI PËR LËNDËT ALGJEBRA VEKTORIALEDHE ANALIZA MATEMATIKE IIA NË FAKULTETIN E SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE NË UNIVERSITETIN E TETOVËS

Me propozim-vendim të Këshillit mësimor shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës dhe Vendim të Këshillit të Rektoratit të datës 20.06.2018 (Nr.ark 02-2672/1 më 22.06.2018) është formuar komision Recensues për zgjedhjen e një asistenti në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore për lëndët: algjebra vektoriale dhe analiza matematike IIA sipas konkursit të publikuar më 04.06.2018 në gazetën e përditshme “Koha” dhe “Nova Makedonija”, si dhe në web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, në përbërje:

1. Dr. Alit Ibraimi, professor inordinar, kryetar i komisionit;
2. Dr. Flamure Sadiku, docent, anëtar dhe
3. Dr. Krutan Rasimi, docent, anëtar.

Komisioni në përbërje të plotë, si më sipër, pasi e kontrollloi materialin e konkursit, titullit të lartpërmendur i paraqet këtë

## RECENSION

Ngakonkursi i shpallur në gazetën ditore “Koha” dhe “Nova Makedonija” dhe në webfaqen zyrtare të Universitetit të Tetovës më 04.06.2018 për zgjedhjen e një asistenti në lëndët algjebra vektoriale dhe analiza matematike IIA u paraqitëndy kandidatë:

1. Mr. Emin Durmishi
2. Mr. Islam Haliti

### 1. Emin Durmishi

#### I. Të dhënat biografike dhe zhvillimi profesional

Kandidati Mr. Emin Durmishi i lindur më 27.11.1988 në fshatin Kamjan të Tetovës shkollimin fillor e kreu në vendlindje ndërsa atë të mesëm në gjimnazin “Kiril Pejçinoviç” në Tetovë. Në periudhën 2008-2012 studioi në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore në degën e matematikës në Universitetin Shtetëror të Tetovës ku diplomoi me mesatare 9.63. Në 2014 në po të njëjtin universitet me mbrojtjen e temës “*Mbi teorinë e pikës fikse në hapësirat metrike kone*” morri thirrjen shkencore magjistër i matematikës me mesatare 9.25. Nga viti 2015 vazhdon studimet e ciklit të tretë në universitetin Shën Kirili dhe Metodi në Shkup.

Emin Durmishi nga viti 2012 është i angazhuar si bashkëpunëtor i jashtëm në katedrën e matematikës në Universitetin e Tetovës. Në periudhën 2013-2016 ka punuar edhe si mësimdhënës i matematikës në shkolla private në arsimin fillor dhe të mesëm. Nga viti 2017 është i angazhuar si bashkëpunëtor i jashtëm edhe në dy universitete tjera: në UEJL (Universiteti i Europës Juglindore) në Fakultetin e Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore si dhe në IBU (International Balkan University) në Fakultetin e Inxhinierisë. Vlen të theksohet se përveç gjuhës



shqipe ai ka ligjëruar edhe në gjuhën angleze (në UEJL dhe IBU) si dhe atë maqedone (në UEJL).

Në shkollimin fillor dhe të mesëm ka qenë mjaft aktiv në garat e shkencave natyrore e në veçanti në matematikë ku vlen të përmenden dy vende të dyta në garat republikane të matematikës (2007 dhe 2008) dhe një medalje bronzi në Olimpiadën Matematikore të Maqedonisë (2007).

Pas diplomimit iu rikthehet garave të matematikës, në fillim në rolin e mentorit për nxënës të shkollave të mesme, ndërsa nga 2017 edhe si anëtarë i komisionit të garave të matematikës për shkolla të mesme në nivel republikan.

Në vitet 2008 dhe 2011 nga Forumi Rinor Islam i ndahen çmimet nxënësi i gjeneratës nga gjimnazi Kiril Pjeçinoviç gjegjësisht studenti i gjeneratës nga Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore në USHT.

Emin Durmishi ka marr pjesë në dy kurse intenzive të organizuara nga DAAD në Prishtinë: në 2012 në kursin “Summability Theory and Statistical Convergence”, si dhe në 2014 në “Measures of Noncompactness and Applications.”

Kandidati Emin Durmishi flet rrjedhshëm gjuhën angleze dhe atë maqedone, ndërsa gjuhët sllave i njeh mjaftueshëm për shfrytëzim literature profesionale.

Në aspektin e njohurive teknologjike ai ka njohuri të mjaftueshme në gjuhët programore C++ dhe TeX si dhe programin Mathematica.

## **II. Veprimtaria mësimore-arsimore**

Kandidati Emin Durmishi nga viti 2012 në Universitetin e Tetovës ka mbajtur mësim (ushtrime) në këto lëndë:

- Gjeometri analitike I, (1 semestër)
- Gjeometri analitike II, (1 semestër)
- Analizë matematike IIA, (6 semestra)
- Analizë matematike IIB, (6 semestra)
- Ekuacione diferenciale të zakonshme, (1 semestër)
- Ekuacione diferenciale parciales, (3 semestra)
- Analizë numerike, (5 semestra)
- Matematikë elementare me praktikum, (5 semestra)
- Hapësira metrike, (2 semestra)
- Algjebër vektoriale, (2 semestra)
- Gjeometri analitike, (2 semestra)
- Algjebër (në programin studimor matematikë në financa dhe biznes), (2 semestra)
- Analizë matematike III (në programin studimor informatikë), (2 semestra)
- Statistikë (në programin studimor inxhinieri ekonomike), (2 semestra)
- Matematikë I (në programin studimor inxhinieri transportuese – komunikacion) (1 semestër) dhe
- Matematikë II (në programin studimor inxhinieri transportuese – komunikacion) (1 semestër).

Nga viti 2017 ka mbajtur ushtrimet si dhe ligjeratat (nën mentorim) në: struktura diskrete I (UEJL), struktura diskrete II (UEJL), probabilitet i aplikuar dhe statistikë (UEJL), kalkulus dhe algjebër lineare (UEJL), matematikë I (IBU) dhe matematikë II (IBU).

### III. Veprimtaria shkencore-hulumtuese

#### A. Artikuj shkencorë

1. **Durmishi, Emin**, Krutan Rasimi, and Alit Ibraimi. "*Finding a metric for a family of contractive functions.*" Int. J. Math. Sci. Engg. Appls.(IJMSEA) 8.6 (2014): 181-188.

#### B. Tubime shkencore

1. **Emin Durmishi**, Alit Ibraimi: *Cannan contractive mappings on cone metric spaces* - ICNES (International Congress on Natural and Engineering Sciences), 01-05 September, 2016, Skopje.
2. **Emin Durmishi**, Alit Ibraimi: *The Banach Contraction Principle on some generalizations of cone metric spaces*- 1st International Conference of Natural Sciences and Mathematics, 16-17 June, 2017 Tetovo.

### IV. Veprimtaria profesionale-aplikative

Kandidati në fjalë ka qenë pjesëmarrës në punën e komisioneve për gara shtetërore edhe atë:

- Anëtarë i komisionit të garave republikane në matematikë për nxënësit e skollave të mesme
- Anëtarë i komisionit i Olimpiadës Matematike të Maqedonisë

### V. Veprimtaria nga interesi më i gjerë

Emin Durmishi ka qenë edhe anëtar i bordit organizativ të dy konferencave ndërkombëtare shkencore:

- 1st International Conference of Natural Sciences and Mathematics, June, 2017 Tetovo.
- 2nd International Conference of Natural Sciences and Mathematics, June, 2018 Tetovo.

## 2. Islam Haliti

### I. Të dhënat biografike dhe zhvillimi profesional

Kandidati Mr. Islam Haliti u lind më 09.04.1963 në fshatin Veshallë, Komuna e Tetovës. Shkollën fillore e mbaroi në f. Veshallë në vitin shkollor 1976/77 në shkollën fillore Besa. Shkollën e mesme e mbaroi në gjimnazin "Kiril Pejçinoviç" të Tetovës në vitin shkollor 1980/81. Gjatë viteve 1981/82 ka qenë në shërbimin ushtarak.

Në shtator të vitit 1986 në Universitetin e Prishtinës në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, dega matematikë, mbaroi studimet deridiplomike.

Nga shtatori i vitit 1986 e deri në vitin 1992 ka ushtruar detyrën e profesorit të lëndës së matematikës pranë QAM "9 MAJ" në Prishtinë.

Gjatë viteve 1987/88 dhe 1988/89 ka ushtruar detyrën e asistentit të Matematikës -I pranë Katedrës së Fizikës në FSHMN të Universitetit të Prishtinës.

Në vitin shkollor 1992/93 punoi si profesor i matematikës në gjimnazin Zef Lush Marku në Shkup.

Në vitet 1993/94 dhe 1994/95 ka punuar si profesor i matematikës në shkollën e mesme Mosha Pijade në Tetovë.

Nga viti shkollor 1995/96 e deri më sot punon si profesor i matematikës pranë gjimnazit Kiril Pejčinoviç në Tetovë.

Nga fillimi me punë i Universitetit të Tetovës ka ushtruar detyrën e asistentit të lëndëve gjeometria analitike, gjeometria projektive, gjeometria deskriptive, algjebra lineare II, matematikë numerike (në degët e matematikës dhe informatikës), metodika e mësimdhënies me hospitim etj.

Nga viti 1996 e deri më 2003 ka qenë pjesëmarrës në projektin “OOCD PISA +” për Republikën e Maqedonisë.

Në vitin akademik 2008/09 u regjistrua si student i rregullt në studimet pasdiplomike në Universitetin Shtetëror të Tetovës, pranë FSHMN, fusha shkencore matematikë. Temën e magistraturës e ka mbrojtur më 25.06.2010 në UT.

Në vitin akademik 2011/12 është regjistruar si student i rregullt në ciklin e tretë të studimeve, program “Metodat probabilitare, statistike dhe metodat e analizës numerike”. Ka mbaruar me provimet dhe është në përgatitje të punimit të disertacionit.

## **II. Veprimtaria mësimore-arsimore**

Kandidati Islam Haliti në Universitetin e Tetovës ka mbajtur mësim në këto lëndë: gjeometria analitike, gjeometria projektive, gjeometria deskriptive, algjebra lineare II, matematikë numerike (në degët e matematikës dhe informatikës), metodika e mësimdhënies me hospitim etj.

## **III. Veprimtaria shkencore-hulumtuese**

Në pjesën e hulumtimit shkencore kandidati Islam Haliti ka dorëzuar çertifikatë për pjesëmarrje në Konferencën e 25-të mbarëkombëtare të organizuar nga Unioni i shkenëtarëve - Stara Zagora, Republika e Bullgarisë, në vitin 2015.

Kandidati Islam Haliti nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi për të dhëna nga veprimtaria profesionale-aplikative si dhe veprimtaria nga interesi më i gjerë.

Kandidati Islam Haliti ka dorëzuar çertifikatë për njohjen e gjuhëve angleze dhe franceze, çertifikatë për mbarimin e studimeve të ciklit të dytë, punimin e magistraturës, vërtetim për vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë, por i mungon diploma për kryerjen e studimeve deridiplomike si dhe dëshmia për mesataren e notave gjatë dy cikleve të para studimore. Gjithashtu i mungon edhe lista e punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara.

## PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Në bazëtë pasqyrës së prezentuar më lartë të të dhënave biografike dhe zhvillimit profesional, aktiviteteve në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-aplikative dhe veprimtarive me interes më të gjerë të kandidatëve, Komisioni konstaton se kandidati Mr. Emin Durmishi në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit) i plotëson të gjitha kushtet për të marr thirje të bashkëpunëtorit asistent.

Duke pasur parasysh atë që u paraqit më lartë, Komisioni recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës që kandidati **Mr. Emin Durmishi** të zgjidhet **asistent** për lëndët **algjebra vektoriale** dhe **analiza matematike IIA**.

Tetovë, 25.06.2018

### KOMISIONI RECENSUES

1. Prof. Dr. Alit Ibraimi, profesor inordinar, kryetar
2. Dr. Flamure Sadiku, docent, anëtar
3. Dr. Krutan Rasimi, docent, anëtar